LIGJ
Nr.10 227, datë 4.2.2010

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8366, DATË 2.7.1998 "PËR SHËRBIMIN GJEOLOGJIK SHQIPTAR (SHGJSH)", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8366, datë 2.7.1998 "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 1 fjalët "me përjashtim të Shërbimit Gjeologjik të Naftës dhe Gazit" shfuqizohen.

Neni 2

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo fjala "Studimet" zëvendësohet me fjalët "Vrojtimet, shërbimet, përgjithësimet dhe monitorimet".

2. Në paragrafin e dytë, fjalët "gjeofizike e gjeokimike të çdo shkalle" zëvendësohen me fjalët "gjeofizike, gjeokimike, përfshirë sizmikën e cekët (inxhinierike), elektrometrinë, magnetometrinë, gravimetrinë, radiometrinë, matjet e emisioneve të radonit në tokë, ujë, ajër, si dhe në mjediset e brendshme, të çdo lloji e shkalle".

3. Në paragrafin e tretë, pas fjalëve "materialeve industriale" shtohet fjala "hidrokarbureve".

4. Në fund të nenit shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

"Promovimi i perspektivës së mineraleve të dobishme.".

Neni 3

Në nenin 7 fjalia e fundit, pas fjalëve "për naftën dhe gazin" shtohen fjalët "si dhe dokumentacioni faktik i punimeve gjeologjike, hidro-gjeologjike dhe gjeologo-inxhinierike të çdo natyre, të kryera nga subjekte private apo shtetërore të fazës së projektzbatimit".

Neni 4

Neni 7/1 riformulohet si më poshtë:

"Neni 7/1

Agjencia e Ujit dhe Basenit dërgon në Arkivin Qendror të Gjeologjisë një kopje të projektit, pas miratimit të lejes së shpimit dhe një kopje të relacionit, për rezultatet e punimeve të kryera, pas miratimit të lejes së shfrytëzimit nga Këshilli i Basenit Ujëmbledhës.".

Neni 5

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Përveç funksioneve të parashikuara në nenet 6, 7 e 7/1, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar kryen shërbime me pagesë për të tretët. Për shërbimet jashtë vendit merret miratimi paraprak i ministrit.”.

Neni 6

Nenet 9, 10, 11 e 12 shfuqizohen.

Neni 7

Neni 14 riformulohet si më poshtë:

“Neni 14

Drejtori dhe zëvendësdrejtori i përgjithshëm emërohen nga ministri.”.

Neni 8

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

Drejtori i Përgjithshëm ka këto kompetenca:
a) drejton dhe është përgjegjës për menaxhimin e veprimtarisë së institucionit;
b) përfaqëson Shërbimin Gjeologjik Shqiptar në marrëdhëniet me të tretët.”.

Neni 9

Në nenin 16, fjalët “organet drejtuese” shfuqizohen.

Neni 10

Neni 17 riformulohet si më poshtë:

“Neni 17

Struktura, nivelet e pagave dhe të shpërblimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

Neni 11

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar financohet nga buxheti vjetor, si dhe nga të ardhurat për shërbimet për të tretët.”.

Neni 12

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

Ministri përcakton shërbimet me pagesë për të tretët, që kryhen nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar. Tarifat për çdo shërbim për të tretët miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Të ardhurat e krijuara nga tarifat për shërbimet për të tretët përdoren nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar me miratimin paraprak të ministrit, për përmirësimin e punës, nëpërmjet blerjes së pajisjeve, mjeteve teknologjike, aparaturave laboratorike, si dhe për kualifikimin, specializimin e shpërblimin e personelit.”.

Neni 13

Neni 21 riformulohet si më poshtë:

“Neni 21
Dispozitë kalimtare

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të drejtat dhe detyrimet e sh.a. “Gjeoalba”, sh.a. “Hidrogjeologji” dhe sh.a “Gjeologji-Gjeodezi”, pjesa e dokumentacionit gjeologo-inxhinierik dhe gjeodezik të arkivit qendror teknik, si dhe i gjithë dokumentacioni shkencor i këtyre shoqërive i kalojnë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6428, datë 16.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi